U D H Ë Z I M
Nr.1, datë 12.1.2001

NJË SHTESË NË UDHËZIMIN NR.4, DATË 22.8.1994, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR VLERËSIMIN E APARTAMENTEVE, QË NDËRTOHEN ME FONDE SHTETËRORE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

U D H Ë Z O J:

Në pikën 9 të udhëzimit nr.4, datë 22.8.1994, të Këshillit të Ministrave, shtohet shkronja "d", me këtë përmbajtje:

"d. Për ushtarakët, që apartamentet e mëparshme ia kalojnë në pronësi Entit Kombëtar të Banesave, çmimi i shitjes së apartamenteve, të filluar para vitit 1993 me fondet e Ministrisë së Mbrojtjes dhe të përfunduara nga Enti Kombëtar i Banesave ose Ministria e Mbrojtjes, të llogaritet mbi bazën e vlerës reale të apartamentit, në pallat, që do të blejë, duke zbritur vlerën që u takon punimeve të kryera para 1.1.1993 dhe vlerën e apartamentit që dorëzon.

Në rastet kur çmimi i apartamentit, në pallat, që dorëzohet është më i madh se çmimi i apartamentit që merret nga EKB-ja, kjo e fundit nuk merr përsipër pagesën e diferencës".

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta